



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 06 Qershor 2012, në orën 10:00 sala N-10
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE
PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Adem Grabovci, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Besim Beqaj, Ministër/Ministria Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe Ramdan Sejdiu Njësia për Plitika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP/MZHE).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, Mehmet Simnica-zyrtar i fushës për ekonomi, Artan Venhari dhe Albert Krasniqi- KIPRED.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për efikasitetin në menaxhimin dhe monitorimin e Kompanive të Ujërave. I ftuar z. Besim Beqaj, Ministër/MZHE, z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm
3. Të Ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Propozoi që pjesë e rendit të ditës të përfshihet edhe procesverbali nga mbledhja e kaluar, meqenëse është shpërndarë me kohë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës me propozimin e kryetarit të Komisionit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 23.05.2012

Armend Zemaj – Ishte i mendimit që në procesverbal të mos përdoren shkurtesat, meqenëse kjo për publikun mund të jetë e paqartë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 23.05.2012, me propozimin e deputetit Armend Zemaj.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për efikasitetin në menaxhimin dhe monitorimin e Kompanive të Ujërave

Kryetari – Propozoi që shqyrtimi i kësaj pike të rendit të ditës të bëhet në një mbledhje tjetër të Komisionit, meqenëse ministri nuk është i pranishëm. Zëvendësministri ka kërkuar që të prezantoj në këtë mbledhje, por duke pasur një qëndrim të Komisioni, nuk ka pranuar që Zëvendësministri të jetë i pranishëm. Hap diskutimin.

Ramiz Lladrovci – Ndau mendimin me kryetarin e Komisionit. Ndoshta ka arsye për mungesën e ministrit, por edhe ka arsye që Komisioni ka anuluar takimin e datës 31 për shkak të punimeve të mbledhjes plenare. Ishte i mendimit që Ministrit t'i jepet edhe një mundësi. Komisioni ka një rregullore sipas së cilës vepron. Përgjegjësi kryesor sipas raporteve të ZAP-it është Ministri dhe Komisioni e thërret në përgjegjësi vetëm Ministrin. Në rastin tjetër Komisioni mund t'a shqyrtoj raportin pa praninë e ministrit dhe të njëjtin ta procedoj në mbledhje plenare.

Bali Muharremaj – Ndau mendimin lidhur me shtyrjen e shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës. Komisioni ka një vendim lidhur me këtë çështje dhe duhet të veproj njëjtë për të gjitha organizatat buxhetore (OB), përderisa nuk ka një vendim tjetër të Komisionit.

Albert Kinolli – Është dakord që kjo çështje të shtyhet, por qëllimi është që takimi të shtyhet në një datë të arsyeshme, në mënyrë që ministri të jetë i pranishëm.

Valbona Dibra – Ishte e mendimit që shtyrja e kësaj pike të bëhet në mënyrë të koordinuar me agjendën e Komisionit, meqenëse Komisioni ka për të realizuar udhëtimin zyrtar. Propozoi që kjo çështje të shtyhet për fundin e muajit Qershor.

Kryetari – Kërkoj nga MZHE që të përgatisë raport të detajuar për të gjitha bordet: listën e bordeve, anëtarët e bordeve, si dhe mënyrën e pagesës së tyre.

Armend Zemaj – Komisioni vazhdimisht gjatë punës së tij ka pasur problematika me anëtarët e bordeve. Agjensionet kur kanë raportuar në Komision, ka pasur raste kur është konstatuar se njëri nga anëtarët e bordit ka pasur konflikt interesi. Komisioni nuk ka informacion se kush janë anëtarët e bordeve. Në pyetje është përgjegjësia institucionale dhe bazuar në këtë për kryerjen me sukses të përgjegjësi të tij, Komisioni ka nevojë për këto informata.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

2. *Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për efikasitetin në menaxhimin dhe monitorimin e Kompanive të Ujërave, shtyhet për në mbledhjen e cila do të organizohet në fund të muajit Qershor 2012.*
3. *Ministria e Zhvillimit Ekonomik, të përgatisë Raport të detajuar i cili duhet të përmbajë: Listë të detajuar të Bordeve, numrin e anëtarëve të Bordeve, përgatitjen profesionale, lartësinë e pagave të kryesuesit dhe të anëtarëve të Bordit si dhe shpenzimet tjera operationale që lidhen me funksionimin e Bordeve.*

5. Të Ndryshme

a). Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës Rregullore për Ujë dhe Mbeturina lidhur me zgjidhjen afatgjate të çështjes së auditimit të brendshëm

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit se ZRRUM ka proceduar kërkesën për zgjidhjen afatgjate të auditimit të brendshëm nga Kuvendi. Në kuadër të kësaj duhet diskutuar për agjensionet e themeluara nga Kuvendi të cilat nuk kanë plotësuar kushtet për auditorë të brendshëm.

Ismet Krasniqi, Kuvendi i Kosovës – Tha se Kuvendi i Kosovës ka një auditor të brendshëm dhe shuma totale e buxhetit është 15 milion e 800 mijë euro. Kështu që me një auditor të brendshëm, Kuvendi e ka ta pamundur të kryej të gjitha punët. Kuvendi ka pasur disa kërkesa nga agjensionet e themeluara nga Kuvendi dhe deri më tani Kuvendi mbulon disa institucione me zyrtarë të prokurimit dhe me zyrtar certifikues. Për auditim Kuvendi me numrin e auditorëve që ka aktualisht, kjo është e pamundur. Agjensionet kanë një buxhet të mjaftueshëm sa për të siguruar një auditorë të brendshëm. Kërkesa e Kuvendit për punësimin e zyrtarëve të rinj nuk është përkrahur dhe tani për tani Kuvendi nuk ka mundësi të kryej auditimin e brendshëm të agjensioneve. Nëse Kuvendi merr përsipër kërkesën e Ministrisë së Financave, atëherë i duhen 10 auditorë. Pastaj me raportin e progresit është vlerësuar se Kuvendi ka nevojë për zyrtarë të lartë ligjor në Departamentin Ligjor. Kështu që në këtë kohë për Kuvendin kjo është e pamundur që të realizohet.

Kosumu Aliu, NJQHAB/MF – Pas konsultimeve me shumë ekspert kanë ardhur në përfundim që me ligj t`ju lehet mundësia që vet Organizatat Buxhetore të krijojnë Njësitë e Auditimit të Brendshëm. Po ashtu është lënë mundësia që dy e me tepër organizata me marrëveshje të krijojnë një njësi të përbashkët të auditimit të brendshëm apo edhe mund të blejnë shërbime të auditimit të brendshëm. Në këtë moment për organizatat që i raportojnë Kuvendit, duhet të themelohet një njësi brenda Kuvendit, që do të ofronte shërbime për të gjitha këto agjensione. Versioni i dytë do të ishte që të mblidhen përfaqësuesit e të gjitha Organizatat Buxhetore dhe të formojnë një Njësi të auditimit të brendshëm. Duhet të shikohet edhe mundësia e transefereve të brendshme të auditorëve. Ligji i auditimit të brendshëm obligon secilën Organizat Buxhetore që të themeloj Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

Valbona Dibra – NJQHAB është e themeluar me ligj në kuadër të Ministrisë së Financave dhe propozimi për themelimin e një tjetër njësie në kuadër të Kuvendit nuk ka bazë ligjore. Njësia e auditimit në kuadër të Ministrisë së Financave deri më tani ka kryer auditimin e agjensioneve të pavarura. Kjo njësi duhet të fuqizohet me staf shtesë- kjo duke u bazuar në fjalimin e Ministrit të Ministrisë së Financave, para Komisionit- i cili ka thënë se “*asnjë kërkesë për auditorë të brendshëm nuk do ta refuzoj*”. Zgjidhja adekuate është që të shtohet numri i auditorëve të brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave dhe pastaj me organogram të përcaktohet që dy apo

tre auditorë të merren vetëm me auditimin e agjensioneve të pavarura dhe të njëjtit të marrin pagë e jo të kompensohen për punën e bërë.

Armend Zemaj – Duhet të ndryshohet ligji për të realizuar propozimin e NJQHAB, lidhur me themelimin e një njësie tjetër të auditimit në kuadër të Kuvendit. Ministri ka deklaruar në Komision se ka pranuar të gjitha kërkesat për auditorë të brendshëm. Pastaj, Ministria e Financave ka Departamentin e veçantë që merret me këto auditime. E metë e kësaj Qeverie dhe e Qeverive të tjera është se kanë themeluar numër të madh të agjensioneve të pavarura. Dhe nëse shtohet njerëz dhe kosto buxhetore, atëherë si do të realizohet marrëveshja me FMN për numër të punëtorëve. Këtë çështje duhet ta zgjedhë Ministria e Financave dhe NJQHAB, ndërsa Kuvendi nuk duhet të ngarkohet me këtë gjë.

Kosum Aliu - NJQHA është mekanizëm që bënë politika. Njësia e auditimit të brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave bënë auditime më kërkesë, e cila ka bërë dhe bënë auditimin e agjensioneve. Mirëpo, ideja është të krijohet diçka e qëndrueshme dhe funksionale. Mekanizmat e Kuvendit janë mbi Qeverinë dhe auditimi nga njësia e Ministria e Financave i bie auditim nga jashtë dhe këtë e bënë ZAP-i.

Valbona Dibra – NJAB në kuadër të ministrisë duhet të forcohet, domethënë të shtohet numri i auditorëve. Ideja është që të gjendet zgjidhje në kërkesën e cila i është drejtuar Komisionit.

Ibrahim Gjylderan, ZAP- Kuvendi duhet të themeloj një Njësi të auditimit të brendshëm që do të merrej me auditimin e agjensioneve të pavarura. Auditimi nga Qeveria nuk mund të kryhet, sepse kjo njësi është pjesë e ekzekutivit dhe me këtë mund të komprometohet pavarësia e këtyre institucioneve. Ka pengesa të ndryshme ligjore dhe administrative për themelimin e kësaj njësie në kuadër të Kuvendit, mirëpo kjo do të ishte zgjedhja më e mirë.

Ramiz Lladrovci – Meqenëse edhe vetë auditori e pranon që ka pengesa ligjore, atëherë pse bëhen propozime që të kryhet auditimi nga Kuvendi apo që të themelohet një njësi e ne kuadër të Kuvendit për të kryer këto auditime? Propozimi do të duhej të jetë për ndryshimin e ligjit, e pastaj bazuar në ligj të bëhen propozimet lidhur me këtë çështje!

Murselj Haljilji – Këtu një çështje është e qartë, nuk mund të flasim për auditim të brendshëm për agjensionet e pavarura, nëse kjo bëhet nga auditori i jashtëm. Duhet marrë iniciativë për të ndryshuar ligjin dhe jo të kërkohen zgjidhje që nuk janë adekuate dhe nuk janë të parapara me ligj.

Kryetari – Propozoi që këtë çështje Komisioni ta diskutoj në një mbledhje tjetër.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. *Auditimi i brendshëm për Organizatat Buxhetore të cilat nuk plotësojnë kushtet për të pasur auditorë të brendshëm përfshirë këtu edhe ZRRUM-in, duhet të kryhet nga Departamenti i auditimit të brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave.*

2. *Komisioni çështjen e auditimit të brendshëm të agjensioneve të pavarura do ta diskutoj në një mbledhje të radhës, ku do të ftoj përfaqësues nga Ministria e Financave, Departamenti i auditimit, Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm, ZAP-i dhe Kuvendi.*

b) Diskutim rreth Raporteve në pritje për shqyrtim nga Komisioni

Armend Zemaj - Propozoi që Komisioni të filloj me angazhimin e ekspertëve duke pasur parasysh që numri i raporteve të proceduara në Komision është relativisht i madh.

Kryetari – Propozoi që me këtë çështje Komisioni të merret në mbledhjen e radhës.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni në mbledhjen e radhës do të diskutoj rreth angazhimit të ekspertëve.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu